

Kërkesë për Informacion në lidhje me linjat e transportit publik që operojnë në Bashkinë Tiranë

Kthim përgjigje

Përsa i përket kërkesës tuaj për informim lidhur me linjat e transportit publik që operojnë në Bashkinë Tiranë dhe për Linjën nr. 5/A "Ish Kombinati i Autotraktoreve - Qendër" më poshtë ju lutemi të gjeni përgjigjet për pyetjet tuaja:

1. Sa është frekuenca për çdo autobus bazuar në kontratën që operatorët kanë me Bashkinë?

Frekuencat e linjave qytetëse janë të ndryshme nga linja në linjë, në periudha të ndryshe të vitit, dhe gjatë orareve të ndryshme të ditës, në varësi të fluksit të udhëtarëve.

2. A është i afishuar orari zyrtar nëpër stacionet e autobusëve?

Tabelat me oraret e linjave qytetëse nëpër stacione janë pjesë e projektit në punim nga Bashkia Tiranë.

3. Si lajmërohen qytetarët kur autobusi ndryshon trajektoren si pasoje e ndonjë aktiviteti apo ndërtimi?

Bëhet njoftim publik.

4. Cilat janë vendet zyretare ku qytetarët mund të blejnë abonene? A kanë ndryshuar këto vende gjatë muajve të fundit?

Pikat e shpërndarjes për abonet e përgjithshme dhe linjës janë në pika të ndryshme të qytetit.

Përsa i përket aboneve të studentit për muajin Nëntor janë shpërndarë sipas njoftimit më poshtë:

Njoftim

Bashkia Tiranë informon të gjithë studentët se mund të paraqiten në pikat e mëshposhtme për pajisjen me Kartelën e Pajtitit Mujor (**Abone Studenti**):

1. Agjensia Tirana Travel, Bulevardi Zogu I; 2. Agjensia Albatrans, Bulevardi Zogu I-rë; 3. Pranë rrethrotullimit, tek Instituti Bujqësor i Tiranës; 4. Pranë Parlamentit, në krah të godinës së të persekutuarve; 5. Dispeceria në Selitë, pranë Universitetit "Marlin Baleti"; 6. Fillimi i rrugës së Kavajës, pranë "Raiffeisen Bank"; 7. Dispeceria e Unazës, në rrugën "Bardhyl"; 8. Kioska tek rruga e Elbasanit, pranë ish- 7 Xhuxhat; 9. Kioska tek 9-Katëshet; 10. Pas Muzeut Kombëtar (Piazza); 11. Pranë shkollës Harry Fultz; 12. Pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit; 13. Në fillim të rrugës së Kosovarëve, pranë Digës së Liqenit Artificial.

Harta me vendodhjet.

Rreth linjës "Ish Kombinati i Autotraktoreve - Qendër"

1. Sa është frekuenca e ardhjes së autobusit në stacion?

Frekuenca është sipas të dhënave në tabelat e mëposhtme:

Në ditë të zakonshme

PRILL – NËNTOR	05:00 - 24:00
FASHA ORARE	FREKUENCA (MIN)
05:00-06:00	15
06:07-06:30	7.5
06:30-18:00	5
18:00 – 20:00	7
20:00 – 21:30	10
21:30 – 23:00	15
23:00 – 24.00	15

TË SHITUNA, TË DIELA DHE FESTA ZYRTARE

PRILL – NËNTOR	05:00 - 24:00
FASHA ORARE	FREKUENCA (MIN)
05:00– 06:00	15
06:00-07:30	7
07:30-08:30	6
08:30-18:00	6
18:00 – 20:00	6
20:00 – 21:30	7
21:30 – 23:00	15
23:00 – 24:00	20

Në ditë të zakonshme

DHJETOR – MARS	
05:30 - 23:30	
FASHA ORARE	FREKUENCA (MIN)
05:30-06:30	15
06:37-07:00	7.5
07:00 – 18:30	5
18:30 – 20:30	7
20:30 – 22:00	10
22:00 – 23:30	15

TË SHTUNA, TË DIELA DHE FESTA ZYRTARE

FASHA ORARE	FREKUENCA (MIN)
05:30– 06:30	15
06:30-08:00	7
08:00-09:00	6
09:00-18:30	5
18:30 – 20.30	6
20:30 – 22:00	7
22:30 – 23:30	15

2. Në cilën orë vjen autobusi i fundit?

Shërbimi i transportit është:

- a. Në periudhën: **Prill – Nentor**, çdo ditë në orën deri në orën **24.00**

b. Në periudhën: Dhjetor – **Mars**, çdo ditë në orën deri në orën **23.30**

4. Si i lajmëron linjat e autobusit qytetarët kur ndryshohet orari apo trajektorja?

Në rastet kur ndryshimi ndodh për një periudhe të shkurtër, njoftimi bëhet nga faturiono i autobusit.

5. Me sa autobusë operon linja dhe sa duhet të jetë numri optimal?

Numri maksimal i mjeteve që duhet të operojë linja qytetëse Nr.5/A "Ish Kombinati i Autotraktoreve - Qendër" është në oraret e pikut të trafikut, 12 mjete.